

VENDIM
Nr.581, datë 10.9.2004

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR MEDALJET QË I JEPEN
PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21 të ligjit nr.9215, datë 1.4.2004 “Për medaljet për personelin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e shpërblimit për medaljet që u jepen ushtarakëve dhe punonjësve civilë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të jetë si më poshtë vijon:

a) Për medaljet që jep Ministri i Mbrojtjes:

Medalja “Për shërbime të shquara”	14 000 lekë;
Medalja “Për pjesëmarrje në shërbime ndërkombëtare”	9000 lekë
Medalja “Për shërbime të larta” për punonjësit civilë	9000 lekë

b) Për medaljet që jep Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura:

Medalja “Shpëtoj jetë”	9000 lekë
Medalja “Për shërbime të veçanta”	9000 lekë
Medalja “E karrierës”	4000 lekë
Medalja “Komandanti” për komandantët e brigadës	4000 lekë
Medalja “Për shërbim në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm”	5000 lekë
Medalja “Nderi për shërbim ushtarak”	5000 lekë
Medalja “Plagosur në luftë”	9000 lekë

c) Për medaljet që jep komandanti i forcës (komandanti i komandës mbështetëse):

Medalja “E karrierës”	3000 lekë
Medalja “Komandanti”, për komandantët e batalionit	3000 lekë
Medalja “E shërbimit”	3000 lekë
Medalja “Për rezultate të larta në përvetësimin e programit mësimor”	2000 lekë

ç) Për medaljet që jep komandanti i brigadës:

Medalja “Komandanti”, për komandantin e kompanisë	2000 lekë
Medalja “Qitës i dalluar”	1000 lekë

2. Shpërblimi për medaljen “Repart i shquar” i jepet repartit në dhurata, me vlerë deri në 5000 lekë, të cilat ekspozohen në mjediset e repartit.

3. Dhënia e medaljeve ushtarakëve të huaj, nga autoritetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, shoqërohet me dhurata, me vlerë deri në 10 000 lekë.

4. Shpërblimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, jepen nga Ministri i Mbrojtjes, komandanti i forcës, komandanti i komandës mbështetëse dhe komandanti i brigadës.

5. Shpërblimet për medaljet që jep Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, jepen nga autoritetet e përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi.

6. Ministria e Mbrojtjes planifikon çdo vit buxhetor një fond për përballimin e shpërblimeve të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2005.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano